

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali/ Policia rrugore iu hap rrugën kamionëve të "Alesio-2014" në orarin e ndalimit të qarkullimit
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/skandali-policia-rrugore-shoqeron-kamionet-e-alesios-ne-orarin-e-ndalimit-te-qarkullimit/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:26:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:25:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	43cb8cd86acb87b8f5bd269350d7a423741124f2dbff47adfffb26b6341db97c
TEKSTI	f0bb8f5b6eb7e2c2151d7b7c4de28474d1f29e45963dc1d0a80e31d95d49d9fe
PAMJA	63fe474ec461c072165628411687da19e7538c6230df62e04d8be6c7f93b2ba0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	362813088228e16d6f85ad972ed67451bae8c8c66cdd759177fe70c64101533a
E MËPARSHMJA	44462d12264ad531a5522d744991fdef5200403f1d0865c301b68d91712ba1a4
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/362813088228e16d6f85ad972ed67451bae8c8c66cdd759177fe70c64101533a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Skandali/ Policia rrugore iu hap rrugën kamionëve të “Alesio-2014” në orarin e ndalimit të qarkullimit

18:25:15/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE



Një situatë skandaloze është fotografuar pasditen e kësaj të marte, (15 shtator 2026) në zonën e Unazës së Vogël në Tiranë.

Një kamion i kompanisë “ALESIO-2014” është fotografuar duke qarkulluar në një nga zonat më të ngarkuara të kryeqytetit, **rreth orës 18:00**, në një fashë orare kur lëvizja e mjeteve të tonazhit të rëndë është e kufizuar.

Siç mund të shihet edhe në pamjet e mbërritura në redaksinë e **Boldnews.al**, kamioni Mercedes, me logon “ALESIO” të vendosur në pjesën e përparme të mjetit, është duke qarkulluar ndërsa pranë tij ndodhet një automjet i **Policisë Rrugore**.



TË GJITHA



Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

18:52 - 15/09/2026



“Dita 5”/ Bardhi: SPAK po hesht për rëndimin e masës ndaj Ballukut, pse po i jep kohë Ramës?

18:41 - 15/09/2026



Tre shenja lënë pas periudhën e vështirë

18:32 - 15/09/2026



Skandali/ Policia rrugore iu hap rrugën kamionëve të “Alesio-2014” në orarin e ndalimit të qarkullimit

18:25 - 15/09/2026



Sot protesta e 108-të kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh

18:20 - 15/09/2026



Italia zgjat pezullimin e marrëveshjes së Shengenit për 15 ditë të tjera, Madridi: Absurde dhe e panevojshme

18:12 - 15/09/2026



Vendi që i paguan qytetarët e tij për të lexuar

17:57 - 15/09/2026



Vlen të theksohet se këto pamje janë regjistruar në një orar kur qarkullimi i mjeteve të tonazhit të rëndë është i ndaluar në këtë zonë. Sipas rregullave të Bashkisë së Tiranës, qarkullimi i mjeteve të rënda brenda Unazës së Vogël ndalohet nga ora **07:00 deri në 20:00**, ndërsa veprimtaria e furnizimit lejohet në fashën 20:00–07:00.

Lexo edhe:

Protesta te "Rruga e Durrësit", policia arreston 12 qytetarë, procedohen 15 të tjerë

I mori mijëra € qytetarit për legalizim fals, "punonjësja" e Kadastrës kapet në kafe në flagrancë

Sipas denoncimit, të mbërritur në redaksi, në kryqëzime kishte edhe punonjës të tjerë të qarkullimit, por askush nuk tentoi ta ndalojë dhe të verifikojë nëse kamioni ishte pajisur me leje të posaçme për të qarkulluar në orarin e ndaluar.

Pamjet e regjistruara në terren tregojnë se betonieret dhe kamionët e tonazhit të rëndë duket se kanë nisur të lëvizin gjithnjë e më të pashqetësuar në rrugët e Tiranës, madje edhe në praninë e efektivëve të Policisë Rrugore.

Ndërkohë vlen të theksohet, se kompania **"ALESIO-2014"**, emri i së cilës identifikohet në kamionin e fotografuar, është përmendur më herët në një prej **procedimeve pasurore të SPAK**.


Në korrik 2022, Gjykata e Posaçme vendosi sekuestrimin e kompanisë në kuadër të hetimit pasuror ndaj **Anton Gjinajt**, i cili rezultonte ortak i vetëm i saj, me 100% të kapitalit.

Sipas SPAK, pasuria e sekuestruar përfshinte disa shoqëri tregtare, mes tyre **"ALESIO-2014"**, ndërsa në vitin 2023 Prokuroria e Posaçme kërkoi edhe **konfiskimin** e këtyre pasurive.

Por pavarësisht këtyre të dhënave, dhe kufizimeve të përcaktuara për qarkullim, betonieret vijnë të lëvizin lirshëm në rrugën e kryeqytetit duke ngritur pikëpyetjen se **kush i mbron këto mjete të tonazhit të rëndë që shoqërohen madje edhe nga makina të Policisë Rrugore?**

Etiketa: Alesio-2014 betoniere Policia Rrugore Tiranë

Lajme të lidhura





Protesta te "Ruga e Durrësit", policia arreston 12 qytetarë, procedohen 15 të tjerë

10:49 : 15/09/2026



I mori mijëra € qytetarit për legalizim fals, "punonjësja" e Kadastrës kapet në kafe në flagrancë

21:54 : 14/09/2026



Pesë shkolla në Astir?! Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar

16:10 : 14/09/2026



Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike

11:42 : 14/09/2026



Nisja e viti të ri shkollor shkakton kaos në qarkullim, rradhë kilometrike deri në afërsi të Paskuqanit

09:32 : 14/09/2026



"2 muaj pa ujë"/ Punimet në Kombinat lënë banorët pa furnizim, tubacioni kryesor i dëmtuar

19:41 : 13/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

